



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK

**PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT BASHKIAK SHKODËR DATË
18.12.2025**

Me datë 18.12.2025, u mbajt mbledhja e Këshillit Bashkiak Shkodër. Këshilltarë të pranishëm ishin: Oltion Luli, Edmond Ndou, Uarda Gjekaj, Hilmi Lakti, Jona Leqejza, Fatbardh Dama, Vjollca Petani, Erald Erkocaj, Armela Brahimi, Ardit Taflaj, Hedije Nasa, Alma Mehmetaj, Erlinda Kavaja, Taulant Shahmani, Jurgena Bracaj, Gjovalin Ndoj, Aleksander Pashuku, Florian Bjanku, Joniz Osmanagaj, Irena Shala, Valjeta Bajraktari, Irma Kopliku, Artan Haxhi, Gjenarin Kapcari, Elis Doci, Eliona Shkrela, Ardit Behri, Glorja Shllaku, Imeldi Sokoli, Gjergj Sokoli, Rezarte Pode, Lulash Nika, Jetmira Rraboshta, Ervin Brahimi, Marina Duhani, Sead Jusha, Ardita Spahija, Violeta Perndrecaj, Samed Bushati, Fatmit Vojvoda, Anita Amuli, Suada Kopshti, Plarent Anamali, Muharrem Shkjau.

Mbledhja hapet nga Kryetari i Këshillit **Z.Oltion Luli**
Rendi i ditës së mbledhjes është si vijon:

1. *Projektvendim: "Për përdorimin e fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike (deri në 6%) për muajin Nëntor 2025"*.
2. *Projektvendim: "Për plotësimin e vakancës dhe dhënien e mandatit të anëtarit të Këshillit Bashkiak."*
3. *Projektvendim: "Për miratimin e nivelit të bursave për nxënësit e viteve të para, viteve të dyta e lart të shkollave të mesme, për vitin shkollor 2025-2026"*.
4. *Projektvendim: "Për disa ndryshime dhe shtesa në VKB nr.1, datë 22.01.2025 "Për Taksat dhe Tarifat vendore në Bashkinë Shkodër ", i ndryshuar.*
5. *Projektvendim: "Për miratimin e kalendarit të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm 2027-2029 dhe buxhetit vjetor 2027"*.

6. *Projektvendim: "Për miratimin e planit të aktiviteteve të Këshillit Bashkiak Shkodër për vitin 2026"*.
7. *Projektvendim: "Për miratimin e buxhetit të vitit 2026 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2026-2028 të Bashkisë Shkodër"*.
8. *Diskutime jashtë rendit të ditës.*

Kourumi i domosdoshëm është prezent në sallë, mbledhja deklarohet e hapur.

Z. Luli bën leximin e rendit të ditës, dhe sqaron se pika 2. e rendit duhet të hiqet duke qenë se Komisioni Qendror i Zgjedhjeve nuk ka sjellë akoma vakancën. Rendi i ditës hidhet në votim ku rezultojnë **36** vota Pro **0** Kundër **0** Abstenim. **Miratohet**

Z.Luli po ashtu thotë se para se të kalohet tek pikat e rendit të ditës do kalohet në votimin e procesverbalit të mbledhjes së kaluar të Këshillit bashkiak datë: 27.12.2025.

Procesverbali hidhet në votim , ku rezultojnë **37** vota Pro **0** Kundër **0** Abstenim. **Miratohet**

Vijohet me pikën 1.: *Projektvendim: "Për përdorimin e fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike (deri në 6%) për muajin Nëntor 2025"*.

Znj.Pode shprehet se kjo pikë nuk nevojë për relativim, prandaj kalohet tek mendimi i Kryetarëve të grupeve, ku të gjithë shprehin dakordësi me projektaktin.

Pr/akti hidhet në votim, ku rezultojnë **40** vota Pro **0** Kundër **0** Abstenim. **Miratohet**

Kalohet tek pika e rradhës: *Projektvendim: "Për miratimin e nivelit të bursave për nxënësit e viteve të para, viteve të dyta e lart të shkollave të mesme, për vitin shkollor 2025-2026"*.

Edhe për këtë pikë propozohet nga këshilltarët që nuk ka nevojë për relativim, përsëri kalohet tek mendimet e Kryetarëve të grupeve, ku të gjithë janë dakord me projektaktin.

Pr/akti hidhet në votim, ku rezultojnë **40** vota Pro **0** Kundër **0** Abstenim. **Miratohet**

Vijohet me pikën 4. të rendit të ditës: *Projektvendim: "Për disa ndryshime dhe shtesa në VKB nr.1, datë 22.01.2025 "Për Taksat dhe Tarifat vendore në Bashkinë Shkodër ", i ndryshuar.*

Ky projektvendim, nuk është miratuar për mungësë votash, prandaj kërkohet votimi i tij për ti hapur rrugë procedurave të mëtejshme.

Kalohet tek mendimi i kryetarëve të grupeve, Z.Ndou dhe Z.Sokoli shprehen pro projektvendimit, kurse Znj.Shala shprehet se janë kundër, pasi ato si grup politik kanë kërkuar edhe në komisione që ky projekt vendim të ndahet në dy pjesë sepse nuk janë dakord me tarifat për kopshtet dhe çerdhet.

Pr/akti hidhet në votim, ku rezultojnë 28 vota Pro 11 Kundër 1 Abstenim. **Miratohet**

Vijohet me pikën 5. të rendit të ditës: : “Për miratimin e kalendarit të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm 2027-2029 dhe buxhetit vjetor 2027”.

Z.Luli sqaron se kjo është një praktikë që ndiqet çdo vit, prandaj kalohet tek miratimi i pr/aktit, ku rezultojnë 40 vota Pro 0 Kundër 0 Abstenim. **Miratohet**

Kalohet tek pika 6. e rendit të ditës: *Projektvendim: “Për miratimin e planit të aktiviteteve të Këshillit Bashkiak Shkodër për vitin 2026”.*

Edhe ky është i njëjti plan që përcillet çdo vit, prandaj kalohet menjëherë në votimin e tij, ku rezultojnë 40 vota Pro 0 Kundër 0 Abstenim. **Miratohet**

Vijohet me pikën e rradhës: *Projektvendim: “Për miratimin e buxhetit të vitit 2026 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2026-2028 të Bashkisë Shkodër”.*

Fjalën e merr Kryetari i Bashkisë **Z.Benet Beci**, i cili shprehet ndër të tjera se buxheti i paraqitur sot është një shprehje e qartë e vizionit tonë për zhvillimin e qëndrueshëm të bashkisë. Ai synon përmirësimin e cilësisë së jetës së qytetarëve, forcimin e shërbimeve publike, mbështetjen e grupeve në nevojë dhe investimet në infrastrukturë, arsim dhe mjedis. Ky buxhet nuk është thjesht një dokument financiar, por një angazhim konkret për transparencë, përgjegjësi dhe zhvillim të balancuar në shërbim të komunitetit.”

Për detaje teknike dhe prezantimit të shifrave sipas programeve buxhetore relaton **Znj.Haxhi**, drejtoreshë e Buxhetit në Bashkinë Shkodër.

Vijohet me pyetjet nga ana e këshilltarëve.

Znj.Shestani merr fjalën dhe thotë: Atëherë unë dëgjova me vëmendje dhe e kemi parë buxhetin. E kam qenë edhe pjesë e komisioneve. Dhe nuk dua të hyj në shumë teknika, por kisha pas dëshirë të marr përgjigje prej kryetarit faktikisht. Të shohim një buxhet ku 60% e të ardhurave totale vijnë nga qeveria qendrore, pra 40% janë të ardhurat vendore. Pra, një buxhet që varet prej qeverisë qendrore. A po bën ky buxhet që Bashkia Shkodër ta humbas autonominë reale të saj? Dhe çfarë ndodh, nëse kjo transfertë nga qeverisja qendrore nuk vjen, ose vjen me vonesë, dhe ne nuk arrijmë ti realizojmë këto projekte dhe këto që thuhet. Kjo është pyetja e parë, pastaj nxitem edhe prej fjalës së kryetarit në fillim, që tha që janë rritur investimet dhe këto po përmirësojnë të ardhurat e tjerë e tjerë. Po ashtu shohim edhe një numër të madh projektesh, në një kohë që shohim që investimet edhe në këtë vit parashikohen rreth tetëmbëdhjetë përqind, pak a shumë sa vitin e kaluar. Pra nuk shihet ndonjë diferencë në realizime.

Z.Anamali: Një pyetje kisha lidhur me programin e arsimit. Vërej që tek programi, si politikë është parashikuar edhe trajnimi që i bëhet stafit, konkretisht stafit të edukatorëve dhe të çerdhëve kopshteve. Por vërej që është parashikuar zero lekë lidhur me këtë, pra lidhur me trajnimin e këtij stafi. Dua të di, pse nuk janë parashikuar fonde për trajnimin e tyre.

Z.Sokoli: Unë do të doja që në bazë të asaj çfarë u prezantua dhe atyre rezultateve të pritshme që janë bërë edhe vitin e kaluar, të bëjmë një resyume të kësaj. Po në fakt, ajo çfarë lexoj edhe nga ky prezantim, edhe nga prezantimi i vjetshëm, edhe nga materiali që është dorëzuar si pjesë e buxhetit, pra tek vështrimi i përgjithshëm dhe tek projektet strategjike, mund të them që ajo me çfarë duhet të lidhet buxheti përsa i përket projekteve strategjike, është me patjetër me buxhetin e qeverisjes. Me buxhetin e qeverisë që është miratu në fillim të dhjetorit në parlament, në buxhetin tonë si projekte strategjike kemi dy Lotet e autostradës Adriatiko-Joniane, Lotin Milot Balldre dhe Balldre Moriçan. Në fakt, tek kontratat e partneriteteve publike private në buxhetin e shtetit, këto nuk janë të parashikuara. Dhe nuk bën sens që ne t'i fusim tek buxheti jonë, ndërkohë që në buxhetin e qeverisjes nuk janë të përfshira. E njëjta gjë është që kryetari të citojë rrugën e Dukagjinit. Në buxhetin e qeverisjes, rruga e Dukagjinit nuk përfshihet në buxhet. E njëjta gjë vjen për projektin që vjet u prezantua me pompozitet, është ura mbi lumin Bunë, që lidhet me Ulqinin, që përsëri nuk ka investim përsa i përket buxhetit të shtetit dhe është një projekt i hedhur poshtë tashmë, që ka qenë vjet në buxhetin e bashkisë. Kalojmë në nivelin në shkallë të qytetit për projektet strategjike. Premtohet në projektet strategjike të bashkisë, bypass-i lindor i qytetit. Bypass-i lindor i qytetit ka zero lekë në buxhetin e qeverisjes. Përsa i përket impiantit të trajtimit të ujërave të zeza, është zhdukur nga buxheti i qeverisjes. Nuk ka qenë ndonjëherë në fakt pjesë e buxhetit të qeverisjes. As si mjet nuk është më prioritet për bashkinë, se kuptoj pse. Kemi dhe një sërë projektesh që janë pjesë e mund të themi, programit të Portës së Alpeve. Programi i Portës së Alpeve, me sa kuptoj unë ka një ngërç sepse nuk ka të miratuar kredinë, dhe grantin përsa i përket dy donatorëve që janë KfV-ja dhe Banka Europiane e Investimeve, pra nuk ka të miratuar në buxhet përsa i përket investimeve, hapjes rrugës të investimeve të këtyre projekteve. Një projekt që financohet në këtë kuadër është projekti i kuartetit të muzeumeve, që në fakt është pa financim përsa i përket kësaj, projekti i rehabilitimit të muzeut të kujtesës përsëri është pa financim. Projekti i rrugës biçikletave, që është përsëri pjesë e këtij programi, ngelet pa financim. Po ashtu, një projekt që është pompuar shumë është projekti i rehabilitimit të bulevardit nga Parruca drejt Xhabies, që edhe ky është një projekt që nuk ka investim për momentin, si rezultat i bllokimit të këtij fondi. Përsa i përket kësaj, vijmë në momentin që vitin që kaloi, Bashkia premti dyzet e pesë milionë euro investime për tetëmbëdhjetë muaj. Dhe nga kjo analizë që unë bëra më sipër, rezulton që rezultatet janë shumë herë më poshtë sesa ajo çfarë premtuhej. Dhe këtu lidhet edhe me impaktin ekonomik. Një problem fakt që nuk e ka vetëm Bashkia Shkodër, duhet të jem realist për këtë. Bashkitë cedojnë për të pasur një zhvillim ekonomik lokal sepse mundësitë mund të jenë edhe të pakta, por ju thonë që janë rritur, është rritur numri i turistave dhe që kemi një zhvillim konkret në turizëm. Në fakt, ju jepni një shifër në lidhje me numrin e turistave, ndërkohë për sa i përket vjeljes së taksës së hotelierisë, kjo është më e ulët se në vitin dy mijë e njëzetë e katër. Pra, në vitin 2004 kemi 33 milionë lekë nga taksa e hotelierisë dhe në vitin 2005 kemi vetëm 30 milionë.

Ndërhyn **Z.Luli**, duke thënë se cila është pyetja konkretisht:

Vijon **Z.Sokoli**, po pra, ky hendeku midis numrit të rritur turistave dhe vjeljes taksës, që është më e ulët se në vitin dy mijë e njëzet e katër. Kjo është një sqarim i parë. Dhe Bashkisë Shkodër nuk i mjafton vetëm turizmi, sepse Shkodra ka potencial të jashtëzakonshëm dhe nuk duhet të ngelë vetëm te turizmi, po ne duhet të synojmë që me projektet tona të zhvillojmë patjetër bujqësinë. Patjetër industrinë e lehtë, patjetër biznesin, por vetëm turizmi është shumë i brishtë për të zhvilluar një ekonomi të qenësishme të Shkodrës. Kalojmë më pas tek pikat e programit apo edhe tek shifrat e përgjithshme, ne themi që kemi një rritje të buxhetit dhe kjo rrjedh nga rritja e të ardhurave që

vjen nga taksa e ndikimit në infrastrukturë. Taksa e ndikimit në infrastrukturë rritet me 50%. Mirëpo, po ta interpretojmë këtë rritje, është se ne synojmë që të rrisim numrin e lejeve të ndërtimit dhe ta betonizojmë qytetin. sepse kështu i bjen në qoftë se ne rrisim ndikimin, taksën e ndikimit në infrastrukturë, pra vjeljen e kësaj takes dhe rrisim varësinë ndaj ndërtimit, dhe kjo është një politikë që në afat të gjatë është e dëmshme për qytetin, pra ndikon direkt në dëmtimin e identitetit të qytetit. Pastaj projektet e rrugëve dhe hapësirave të blloqeve të banimit, asnjëri nga këto projekte nuk ka projekt zbatim dhe justifikimi për mosrealizueshmërinë e projekteve. Përsa i përket vitit të shkuar në këtë program, është që ne kemi pasur probleme me tenderimin e projekteve dhe ne themi që realizueshmëria e kësaj është vetëm tridhjetë e pesë për qind në vitin e shkuar. Pra, ky ne nuk sigurojmë dot që të t'i bëjmë këto projekt zbatime nëpërmjet tenderimit dhe kjo është riskioze, sepse është e njëjta situatë me vitin që sapo kaluam. Pra, ju keni një realizueshmëri tridhjetë e pesë për qind në këtë program dhe cila është siguria juaj që ju këto dyqind milionë lekë të reja do t'i investoni, sepse ju keni një realizueshmëri që është shumë e ulët në vitin e kaluar. Kjo është pyetja. Për sa i përket programit të shërbimeve publike. Kemi rreth 50 milionë lekë të reja për sa i përket rehabilitimit të rrugëve rurale dhe në qytet. Pra, janë dyfish projekte. Ndërkohë, nuk kemi një listë rrugësh se cilat do të investohen dhe do të përmirësohen. Pra, ne nuk kemi një qartësi se cilat janë rrugë prioritare të qytetit që ju do të investoni. Ju po i investoni, po i kaloni nëpërmjet ndërmarrjes së shërbimeve publike, por nuk kemi rrugët prioritare. Flas në dokumentin që është dorëzuar. Në buxhet janë gati tetëdhjetë milionë lekë të reja për sa i përket dy kontratave të pastrimit të rrugëve dhe të trotuareve. Kemi një shqetësim të rritur nga qytetarët për sa i përket pastërtisë, po them për menaxhimin e mbetjeve. Në qoftë se ne synojmë të jemi një qytet turistik, këtë pjesë duhet ta kemi patjetër on top. Dhe vijmë tek pika tjetër, për sa i përket lëvizshmërisë, ne kemi rreth njëqind e njëzet milionë lekë të vjetra për tre kryqëzime me semafor. Dhe këtu mbaron vizioni i Bashkisë për sa i përket përmirësimit të lëvizshmërisë për vitin 2006. Mund të them që qyteti ka nevojë ulëritëse për përmirësimin e aksesit të infrastrukturave lehtësuese për njerëzit me aftësi ndryshe. Po marr rastin e rampave në qytet, të cilat kanë nevojë që të kemi një plan të mirëfilltë, që ecë paralel me këtë punë në mënyrë që të ketë përmirësim të aksesit të njerëzve me aftësi ndryshe dhe këtu marr një shembull, rrugën Don Bosko. Rruga Don Bosko është projektuar, është ndërtuar, po zhvillohet në zhvillim e sipër, po implementohet dhe nuk ka rampa sot. Pra, janë mbyllur pjesët e trotuarëve dhe nuk ka rampa. Aq më tepër performanca për ndërtimin e kësaj rrugë është shumë e ulët. Është filluar me 6 qeshor dhe akoma sot nuk ka marrë formë. Dhe pika tjetër, në mbledhjen e fundit të Këshillit, ne miratuam planin e lëvizshmërisë. Shumë mirë që u miratua ky plan i lëvizshmërisë, por ne nuk demonstrojmë qëndrueshmëri dhe përgjegjësi ndaj këtij plani sepse me të ardhurat tona nuk kemi asnjë investim serioz në kuadër të këtij plani. Përkundrazi, kemi disa projekte që ju i përmendët janë projekte strategjike si rruga e Baçallëkut, që ka një qasje komplet të kundërt. Me planin e lëvizshmërisë, pra ka një përplasje qasjesh midis planit të lëvizshmërisë dhe kësaj rruge. Duke mos hyrë edhe në projekte tjera, siç është investimi në Fermentim apo investimi tek rruga Roza Lein. Unë e thashë edhe në mbledhjen e komisioneve, nuk është diçka që ne duhet ta lejojmë, më mirë të bëjmë një investim më të vonshëm dhe ta bëjmë sipas standarteve, se sa të bëjmë thjesht investime dhe mos t'i kapim standardet që na duhen.

Z.Pashuku: Për arsimin, mendoj se në njësinë administrative Bërdicë, me shkollat më të mëdha, është e nevojshme për një palestër, meqënëse është numri i madh i nxënësve. Ka nevojë për ndërhyrje të rjetit elektrik. Edhe pozicioni i shkollës është mes kryqëzimit të rrugëve, në qoftë se është e mundur për të planifikuar dhe për të vënë bume, për arsye se aty mund të ketë edhe rrezik kur fëmijët hyjnë dhe dalin nga shkolla. Së dyti, në lidhje me bujqësinë, siç e theksoi edhe kolegu

Sokoli. Kryetari foli për kanalet kulluese, zona e e Nënshkodrës, ku është edhe sipërfaqja më e madhe, nuk ka pasur probleme me përmbytjet në fakt. Besoj që në drejtimin e bashkisë, janë pastruar shumica e atyre kanaleve kulluese ekzistuese. Si rrjedhojë, nuk ka pasur përmbytje në të. Unë pashë te projektet e rrugëve, gjë që kam theksuar edhe në mbledhjet e tjera; është një projekt në fshatin Beltojë. Projekti është ekzistues, por nuk e shoh tek lista e investimeve në njësinë administrative Bërdicë. Do doja të dija çfarë do bëhet aty.

Z.Osmanagaj: pyetja e parë është për shërbimet sociale. Në këtë dokument, edhe vetë Bashkia pranon se çerdhet në Shkodër janë të mbingarkuara me kapacitete të pamjaftueshme, mungesë hapësirash. Ndërkohë, kërkesa për të përfshirë fëmijët e tyre në këto struktura është gjithmonë në rritje. Por nuk arrij të kuptoj se në programin e afatmesëm dy mijë e njëzet e gjashtë, dy mijë e njëzet e tetë, nuk parashikohet asnjë investim në këto struktura. Kapital për zgjerimin e çerdheve, ndërtimi i ambienteve të reja apo rritje të kapaciteteve. Pyetja ime është, cila është strategjia reale për t'i dhënë zgjidhje këtij problemi nga Bashkia?

Znj.Golemi: Së pari, po e fillojmë me një pyetje drejtuar kryetarit. U fol për zhvillim të turizmit. Por si mund të përmendim zhvillimin e turizmit një kohë që rruga lidhëse e Shkodrës me Tiranën lë shumë për të dëshiruar, edhe pse kjo është rruga kryesore që lidh në rrugë tokësore dhe me Europën. Dua të di nëse kryetari i bashkisë ka lobuar pranë qeverisë për sistemimin e kësaj rruge, sepse është një problem jetik për gjithë zonën e veriut. Dukemi shumë të diskriminuar, meqënëse jemi të vetmit banorë të Shqipërisë, që paguajmë. Aq më tepër që ajo rrugë ka një cilësi që lë për të dëshiruar. Po kaloj te disa pika tjera në lidhje me buxhetin. Shoh një hendek të madh mes planifikimit dhe realizimit në vitin 2025. Si mund të flasim për realizime një kohë që një e treta e buxhetit të vitit kthehet për vitin pasardhës? Gjithashtu, ky hendek vazhdon në qoftë se ne shohim investimet sipas njëmbëdhjetë mujorit, janë realizuar aktualisht vetëm tetë muaj. Atëherë, ne mund të themi që... Kemi një buxhet të madh, por me rezultate të vogla në terren. Një pyetje tjetër është në lidhje me taksat. Shohim se të ardhurat nga tarifat pastrim, ndriçim dhe gjelbërim për vitin dy mijë e njëzetë e gjashtë janë parashikuar me një ulje 4.5%. Pse është kjo? A ka një rilogaritje apo diçka tjetër? Dhe në lidhje me këtë, duhet të shtoj një pyetje. Kemi ndërmarrjen ujësjellës kanalizime si agjent tatimor, i cili është i bllokuar nga subjekte të tjerë. A ka lidhje kjo ulje 4.5% të të të ardhurave të planifikuara me këtë mostransferim? Një pyetje tjetër është në lidhje me një projekt që Giz ka bërë me Bashkinë e Shkodrës për formimin e kompostimit në Rrenc për mbetjet e gjelbërta, a ka rrezik që ky po e quajnë "landfill" i ri t'i shtohet atij të Bushatit nën presionin që pritet të ketë në vazhdim. Kam një pyetje tjetër, shohim se gjatë analizimit të programit të arsimit, kulturës dhe artit, buxheti i këtij viti është 136 milionë më shumë se tavanit buxhetor i miratuar një vit më parë. Pra, kemi një rritje rreth 50%. A tregon kjo një mosbesueshmëri për planifikimin afatmesëm dhe tavanet buxhetore? Po këtu, tek ky program, vihet re që edhe në dy mijë e njëzet e gjashtë, ashtu si po ky vit që po lemë janë parashikuar fonde të konsiderueshme për aktivitetet artistike dhe zbukurimet festive me rrafshin e Krishtlindjes dhe Vitit të Ri. Te ky program shoh që ka një mungesë totale të planifikimit për festat e komunitetit mysliman si Bajrami apo Muaji i Ramazanit. Komuniteti mysliman është një komunitet taksapagues, njësoj si çdo komunitet tjetër. Për këtë arsye, ky planifikim buxhetor krijon një trajtim të pabarabartë dhe bie ndesh me frymën e mirëkuptimit fetar dhe barazisë që ligji dhe kushtetuta na imponojnë. Përveç pyetjes, unë këtu shtroj dhe një kërkesë. A mund të planifikohen fonde për zbukurim me drita dhe gjatë muajit të Ramazanit? Gjithashtu, të zhvillohen aktivitete festive me rastin e Bajramit për të siguruar kështu një atmosferë festive dhe një trajtim të barabartë për të gjithë banorët.

Z.Bjanku: Unë kam dy pyetje. Në këtë buxhet dhe në këto investime të parashikuara, a është menduar ndonjë lloj strategjie se si do të procedohet me mbarimin e punëve publike brenda një afati të caktuar kohor duke respektuar parametrat normale të kantierëve ku ndërhyhet, sepse nuk përmbushin asnjë lloj standardi përsa i takon kohëzgjatjes, përsa i takon procedurave që ndiqen në realizimin e këtyre punimeve. Dhe pa llogaritur edhe pjesën e cilësisë së tyre, do të thotë që këto paratë e taksapaguesve shkodranë do të administrohen mirë, do të thotë pra, a ka parashikime në këtë aspekt, apo do të vazhdojmë me këto projekte të cilat zgjatën në kohë, nuk respektojnë rregullat e kantierit të punimeve, duke rrezikuar edhe jetën e kalimtarëve në këto kantiere të hapura. E së dyti, në lidhje me universitetin. A keni parashikuar diçka në këtë aspekt, duke e ditur që Universiteti i Shkodrës, Luigj Gurakuqi, është një aset shumë i rëndësishëm për realitetin shkodran. Dhe aq më tepër i të rinjve në kuptimin që sot është plaga më e madhe shoqërore që ato janë duke e braktisur vendin. A ka parashikim për ndonjë fond për projekte të përbashkëta apo në raport me qoftë edhe një interesante do të ishte edhe krijimi i një dite studentore, ku mikpritën nga Bashkia, të cilët vijnë në qytetin tone. Kjo është një praktikë e shumë universiteteve të tjera perëndimore. Dhe gjithashtu, çfarë po bëhet me kartën e studentit? Karta studentit është një premtim, i cili është thënë disa herë, por akoma nuk ka një gjë konkrete. Karta e studentit është një instrument, që provon se sa efikase janë shërbimet që ofron Bashkia, domethënë në qoftë se ne i evidentojmë studentët dhe i japim një mundësi që të frekuentojnë me çmime të reduktuara linjat e transportit urban, kinemanë, teatrin, stadiumin e tjerë, këto vënë në një situatë prove edhe funksionalitetin e këtyre.

Znj.Shestani: Shoh këtë programin që është për mbështetje dhe zhvillimi ekonomik dhe vërej që buxheti për 2026 është vetëm dy për qind e buxhetit total të Bashkisë. Dhe shoh që ka një rënie. Fakti që Bashkia parashikon vetëm dy për qind të këtij buxheti, a tregon mungesë vizioni dhe prioritete? Në një kohë që bizneset e vogla po mbyllen, të rinjtë po ikin dhe zhvillimi ekonomik trajtohet si formalitet. Pyetja ime është pse zhvillimi ekonomik është i vetmi program që shkurtohet vit pas vitit? Dhe tjetër, a e konsideron Bashkia zhvillimin ekonomik prioritet apo thjesht një rubrikë formale? Po tek ky program shohim edhe investimet në ekonominë rurale, ku thuhet ku ne mbështesim katërqind fermerë në vit, me një buxhet tetë pikë gjashtë milionë lekë, mesatarisht njëzet e një mijë lekë për fermerë. Pra nuk ka një fond serioz për këtë. Pyetja tjetër është për programin e kulturës për trashëgiminë kulturore. Është më shumë promovim se sa ruajtje mesa shoh unë, promovim me broshura çdo vit. Po mirëmbajtja, fondet për mirëmbajtjen janë të pandryshueshme. A po restaurohet trashëgimia, apo vetëm po promovohet? Pyetja ime, sa monumente realisht janë parashikuar të rikonstruktohen?

Në vazhdim kryetari i Këshillit propozon 10 minuta pushim për përgatitjen e përgjigjeve nga ana e administratës së Bashkisë.

Pas rikthimit, Kryetari i Bashkisë bashkë me stafin e tij, përgjigjet për pyetjet e shtruar.

Vijohet me diskutime rreth projekt aktit të propozuara.

Fjalën e merr **Znj.Shllaku:** E kam parë raportin me shumë vëmendje, edhe përsa i përket programit buxhetor afatmesëm 2027-2028. Po ashtu, e dëgjova edhe kryetarin e bashkisë me shumë vëmendje, kur foli për vizionin për Shkodrën, për Bashkinë e hapur, për transparencë, për llogaridhënie, etj. Duhet të ndalemi tek disa nga investimet. Në qoftë se flasim për zgjerimin e urës së Bahçallëkut dhe rrugës tek Harku i Bërdisë, që ka filluar dhe po bëhet, që avancohet me ritme

shumë shumë të ulëta, mos të harrojmë domethënë që gjatë verës qytetarët shkodranë kanë ndenjur në rresht dhe në trafik me orë të tëra. Dhe nuk e dimë se kur do mbarojë, sepse s'kemi asnjë lloj afati apo një tabelë informuese. Vazhdojmë me rrugën e Dukagjinit, ashtu siç edhe e thanë kolegët e mi, nuk merret vesh me çfarë fondesh financohet, pra se në listën e investimeve të qeverisë nuk kemi asnjë lloj investplani apo shifër. Viojmë me parkun e hyrjes së Shkodrës, I cili ka filluar por se kur mbaron, as këtë nuk e dimë. Ndalemi tek rruga e urës së Bunës, e shkatërruar trotuarin në mesin e sezonit, ku qindra qytetarë shkodranë lëvizin me biçikleta. Në qoftë se keni dashur të investoni, të ishit marrë me sheshin në Shirokë, që një nga kolegët tuaj socialistë e ka quajtur si mozaik, por ta shohësh realitetin është krejt ndryshe. Vioj të ndalem edhe tek pjesa e Shkodrës, vizioni e planet strategjike për një Shkodër të pastër. Kam marrë me vete disa foto që tregojnë se sa e pastër është Shkodra jonë. Kjo është Shkodra, kryetar. Në qoftë se nuk e keni parë, të them me ba një lëvizje, edhe me ec. Të mos të flasim pastaj për kaosin që ka krijuar plani i mobilitetit. Kaosi në qendër të qytetit të Shkodrës, trafik me orë të tëra. Kemi diskutuar disa herë në Këshill për telat në çdo pallat, këndet e lojrave për fëmijët. Pra këro qenkan planet strategjike dhe vizioni për Shkodrën? Parkingjet, asnjëherë të mirëmbënuara, Në qoftë se ne deri tani, Shkodrën e kemi njohur si Shkodra kulturës, historisë, artit, tani e kthejmë në një qytet të papastër, në një qytet që të them të drejtën, më vjen keq se ku ka arritur Shkodra, Prandaj, kryetar, do të kisha thënë që lojnat e propagandat dhe ndoshta këto lajle- lulet t'i thoni nëpër mbledhjet e partisë, se ato mendoj që iu shkojnë. Kurse këtu bëni punën që ju ta kanë besu sepse qytetarët shkodranë paguajnë taksa dhe është përgjegjësi morale e ligjore për t'iu përgjigjur.

Z.Sokoli: Në fakt nuk e kisha ndërmend të flisja, por më detyroi parafolësja, pavarësisht se iu drejtua kryetarit të Bashkisë. Dua të them se realiteti është krejt ndryshe. Ajo që nuk ka ndodhur prej tridhjetë vitesh në Shkodër, ka ndodhur me ardhjen e kryetarit të ri të Bashkisë. Ai foli më parë për arritjet, për ndryshimet që ka Shkodra dhe vazhdon të ketë. Prandaj ju lutem shumë kolegëve mi këshilltarë, që duhet të bëjmë më të mirën e mundshme.

Znj.Petani: Nuk po zgjatem shumë, por me shumë dashamirësi, duhet të themi, që nuk duhet hedhur poshtë puna e Kryetarit të Bashkisë, puna e shumë drejtorëve dhe e gjithë stafit të Bashkisë që po punon fort. Ndryshimi është mëse i dukshëm për të gjithë qytetarët e Shkodrës.

Z.Bjanku del në foltore dhe shprehet se në respekt edhe të kësaj mbledhje, e cila faktikisht është mbledhja më e rëndësishme e vitit për Këshillin Bashkiak të Shkodrës, dëshiron të thotë dy fjalë, ndoshta edhe për t'i ikur paksa atij diskutimi që u bë. Ai vijon më pas me fjalën e tij.

Edhe Zv.Kryetarja **Znj.Qyteza** merr fjalën dhe bën një replikë për atë çfarë u tha nga Znj.Shllaku, duke përsëritur edhe njëherë punën e bërë, dhe ndryshimet që ka pësuar qyteti i Shkodrës nën drejtimin e Z.Beci.

Më pas kalohet në mendimin e kryetarëve të grupeve, Z.Ndou dhe Z.Sokoli shprehen pro projektvendimit, kurse Znj.Shala në emër të grupit të saj shprehet kundër, pasi vërejnë se materiali i paraqitur ka dobësi të qarta strategjike, investimesh të pakta, për më tepër ata mendojnë që kjo e kthen këtë projekt buxhet thjesht në një instrument administrimi dhe jo zhvillimi për qytetin dhe banorët e Shkodrës.

Pr/akti: "Për miratimin e buxhetit të vitit 2026 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2026-2028 të Bashkisë Shkodër", hidhet në votim, ku rezultojnë 30 vota Pro 13 Kundër 1 Abstenim. Miratohet

Pyetje e diskutime të tjera nuk ka, **Z.Luli** e deklaroi mbledhjen të mbyllur.

Procesverbali, pasqyron në mënyrë të përmbledhur diskutimet e mbledhjes së Këshillit Bashkiak Shkodër të datës 18.12.2025. Bashkëlidhur këtij procesverbali, materiali i mbledhjes Audio.(DVD).

Procesverbali përmban 10 faqe dhe pasi lexohet, nënshkruhet pa vërejtje nga:

V.o: Ky procesverbal do miratohet nga anëtarët e Këshillit në mbledhjen e radhës së Këshillit bashkiak.


Sekretar

Sabina DANAJ



Zbardhi Pr/verbalin:

Irma Sulishti



KRYETAR

Oltion LULI

